




# Raport vetëvlerësimi APAAL 2011

**Prof. Dr. Avni MESHI**

**Drejtör**

**AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TE  
ARSIMIT TE LARTE**



Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, APAAL  
Rruga e Durrësit, 219, Tiranë  
Tel/fax : 2 257 954/ 2 266 302  
E-mail: [info@aaal.edu.al](mailto:info@aaal.edu.al)  
web site: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)

Tiranë, Janar 2012

**Përmbajtja:**

- I. Roli i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë në sistemin arsimor**
  1. Misioni, objektivat dhe funksionet e APAAL
  2. Struktura dhe organika e APAAL
  3. Funksionet dhe detyrat kryesore të sektorëve në APAAL
  4. Bashkëpunimi me institucionet homologe
  5. Mendime mbi strategjinë afatgjatë të zhvillimit të APAAL
  
- II. Raport mbi veprimtaritë kryesore të APAAL gjatë vitit 2011**
  1. Vlerësime në kuadrin e licensimit dhe akreditimit të IAL-ve dhe programeve
  2. Renditja dhe analiza cilësore dhe krahasuese institucioneve, fushave dhe programeve në AL
  3. Aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e AL
  
- III. Plani i veprimtarisë për vitin 2012**
  1. Plani i veprimtarive në kuadrin e përmirësimit të organizimit dhe funksionimit të APAAL
  2. Plani i aktiviteteve në kuadrin e vlerësimit, akreditimit, renditjes së IAL dhe analizave në AL
  3. Plani i aktiviteteve në kuadrin e anëtarësimit në ENQA dhe bashkëpunimet ndërkombëtare
  
- IV. Vetvlerësimi i performancës së APAAL**
  1. Analiza vjetore e performancës së APAAL për vitin 2011. Arritjet, problematikat dhe përfundimet

## **I.ROLI I AGJENCISË PUBLIKE TË AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË NË SISTEMIN ARSIMOR**

### **I.1. Misioni, objektivat dhe funksionet e APAAL**

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është një institucion shtetëror dhe publik, pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e krijuar me vendim të KM nr. 303, datë 1.7.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”.

APAAL ka si mision kryesor të saj sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Mbështetur në besimin kryesor se “përgjegjësitë kryesore për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë janë vetë Institucionet e Arsimit të Lartë”, Agjencia, për kryerjen në mënyrë cilësore të misionit të saj, mbështetet në disa parime themelore si respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të Institucioneve të Arsimit të Lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standartet akademike në AL.

Në veprimtarinë e saj APAAL mbështetet në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore si:

- Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar
- Standartet shtetërore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe në standartet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë
- Rregulloren e Sistemit të Akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, etj.

Disa nga funksionet kryesore të APAAL janë:

- Promovimi dhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë në Arsimin e lartë publik dhe privat, kryerja me autonomi të plotë e procedurave të vlerësimit, zgjedhja e metodave dhe instrumenteve të vlerësimit, ngritja e grupeve të ekspertëve të vlerësimit, si dhe formulimi i raporteve dhe rezultateve të vlerësimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- APAAL pranon dhe regjistron kërkesat e IAL-ve për vlerësim dhe akreditim. Ajo përgatit kalendarin vjetor të vlerësimeve dhe ja paraqet atë për miratim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ky kalendar bëhet publik për të gjitha IAL publike dhe private. Gjithashtu, agjencia organizon vlerësimin e treguesëve teknikë dhe në përmbajtje të sistemit të arsimit të lartë.
- APAAL zhvillon veprimtari të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, me qëllim akreditimin e programit/ve të studimit apo të institucionit (publik dhe privat) dhe bën publike raportet dhe rezultatet e vlerësimeve të kryera, përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ekspertëve të vlerësimit, apo konsulentëve, vendas a të huaj, të cilat i

bën publike, pasi merr pëlqimin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Përzgjedhja e tyre bëhet përmes një konkurimi publik. Lista e ekspertëve përditësohet së paku çdo vit.

- APAAL është përgjegjëse për realizimin e proceseve të renditjes/ranking dhe rating të programeve, fushave dhe institucioneve të arsimit të lartë. APAAL në bashkëpunim me KA, kryen dhe shpall renditjen (ranking) e IAL ose diplomave të ngjashme në përputhje me këto rezultate. Shpeshësia e kryerjes së ranking-ut dhe kriteret e tij miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

- Agjencia është përgjegjëse për realizimin e indikatorëve dhe treguesëve për matjen e cilësisë. Në këtë drejtim APAAL bashkëpunon me grupe ekspertësh dhe me institucione të arsimit të lartë.

- Në shërbim të politikave të arsimit të lartë, agjencia kryen vlerësime analitike dhe/ose krahasuese të institucioneve dhe të programeve të fushave të arsimit të lartë, sipas treguesve të caktuar dhe në raport me standardet ekzistuese, vendase apo ndërkombëtare.

- Mbështetur në kriteret të qarta, mbi të dhëna të sakta e të besueshme dhe në rezultatet e vlerësimit APAAL harton raporte analitike të sistemit të arsimit të lartë sipas një ose disa aspekteve apo treguesve.

- Agjencia bashkëpunon me institucionet publike dhe private të arsimit të lartë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke rekomanduar kriteret, metodat dhe indikatorët e përgjithshëm, si dhe kriteret e metodat e përshtatshme për vetëvlerësimin periodik të sistemit. Ajo udhëzon dhe trajnon njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe mban marrëdhënie të vazhdueshme me këto njësi.

- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me rrjetet e agjencive për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe ato që operojnë në rang ndërkombëtar. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me Institucionet e Arsimit të Lartë në vend dhe institucione që lidhen me to, organizata profesionale, institucione që lidhen me tregun e punës, për shkëmbim informacioni dhe ekspertizë duke i përfshirë aktivisht në procesin e vlerësimit të jashtëm.

- APAAL bashkëpunon edhe me këshillat studentore duke i përfshirë këta aktorë në procesin e vlerësimit të jashtëm si dhe për mbledhje informacioni e të dhënash që i shërbejnë vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në AL në tërësi.

- Në bashkëpunim me KA, APAAL harton në fund të çdo viti një raport të veprimtarisë së saj, i cili i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe më pas bëhet publik brenda 4 mujorit të parë të vitit pasardhës.

- APAAL jep, përmes faqes zyrtare të saj informacion publik të përditësuar mbi statusin e IAL-/programeve lidhur me vlerësimin dhe akreditimin, rezultatet e rankimit dhe të analizave në AL.

- APAAL lëshon Çertifikatën Përfundimtare të Akreditimit pas marrjes së akreditimit.

## **I.2. Struktura dhe organika e APAAL**

Në bazë të vendimit të KM, nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë", APAAL është riorganizuar në tre sektorë dhe numri i punonjësve është rritur nga 11 në 15. Organika aktuale e institucionit është si vijon:

- Drejtori i APAAL
- Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë,
- Sektori i Statistikave dhe Analizave,
- Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit,

Nëpërmjet këtij ristrukturimi, APAAL ka përmirësuar funksionimin e saj për arritjen e objektivave kryesorë në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Shqipëri. Vendimi Nr. 368, datë 14.04.2011, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar, përcakton funksionet dhe detyrat e dy organeve kryesore të sistemit të akreditimit në Shqipëri, APAAL dhe Këshillit të Akreditimit.

## **I.3. Funksionet dhe detyrat kryesore të sektorëve në APAAL**

### ***- Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë***

Ky sektor është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe 5 specialistë. Këta specialistë mbulojnë fushat kryesore të studimit akademik. Mbështetje në këtë sektor japin ekspertët e fushave të ndryshme akademike, të cilët angazhohen për të kryer vlerësimet e jashtme. Një nga detyrat kryesore të këtij sektori është vlerësimi i institucioneve të reja të arsimit të lartë (publik dhe privat) si dhe të programeve të reja të studimit në kuadrin e hapjes/licensimit të tyre. Ky sektor gjithashtu, ka si detyrë parësore organizimin dhe monitorimin e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, që ofrojnë këto institucione (publike dhe private). Asistenca teknike e logjistike, që i ofrohet Këshillit të Akreditimit dhe ekspertëve të vlerësimit me të cilët APAAL bashkëpunon, janë disa nga detyrat e tjera të këtij sektori. Gjithashtu, organizimi i aktiviteteve trainuese dhe promovuese të cilësisë në Arsimin e Lartë, në bashkëpunim me të gjithë faktorët e interesuar është një nga detyrat e rëndësishme të këtij sektori.

### ***- Sektori i Statistikave dhe Analizave***

Është strukturë e re e krijuar në vitin 2010 dhe ka në përbërjen e vet 3 specialistë dhe përgjegjësin e sektorit. Me miratimin e rregullores së re të sistemit të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë, ky sektor ka një rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm në strukturën e APAAL dhe sistemin e arsimit të lartë në tërësi. Detyrat themelore të këtij sektori janë: rankimi/renditja e institucioneve të arsimit të lartë dhe e programeve të studimit, analiza cilësore e krahasuese në arsimin e lartë për institucionet, programet apo aspekte të veçanta të tyre si stafet akademike, kërkimi shkencor, facilitetet etj, mbledhjen e të dhënave për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe krijimin e databazës kombëtare për IAL-të në tërësi. Këto të dhëna do të

shfytëzohen nga institucionet e tjera vendimmarrëse e politikëbërëse për hartimin e politikave në arsimin e lartë me qëllim përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë në vend. Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e këtij sektori zë përgatitja e materialeve, raporteve dhe të dhënave për publikim dhe informim. Stafi i këtij sektori angazhohet gjithashtu në të gjitha aktivitetet dhe proceset që APAAL zhvillon në fushën e arsimit të lartë.

#### ***-Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit,***

Ky sektor ka në përbërjen e vet 3 punonjës dhe përgjegjës të sektorit. Pjesë e këtij sektori janë financa dhe protokoll/arshiva e APAAL. Aktiviteti i tij kryesor është fokusuar në mbështetjen financiare dhe logjistike të APAAL, KA dhe ekspertëve vendas dhe të huaj. Ky sektor kryen gjithashtu publikimin e materialeve dhe botimeve të APAAL/KA në kuadër të informimit të publikut.

#### **I.4. Bashkëpunimi me institucione homologe**

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, gjatë vitit 2011 është fokusuar gjërësisht në bashkëpunimin ndërkombëtar me institucione dhe agjenci të tjera që operojnë në fushën e arsimit të lartë. APAAL, është anëtare me të drejta të plota në tre rrjete rajonale e ndërkombëtare, CEE Network, INQAHE, EAIE, dhe prej vitit 2010 është anëtar i asociuar i ENQA (Organizata Europiane për Sigurimin e Cilësisë). Agjencia ka qënë pjesë e të gjitha aktiviteteve të organizuara nga këto rrjete e organizma. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar përgatitjes paraprake të APAAL për anëtarësimin e plotë në ENQA. Pjesë e këtyre aktiviteteve kanë qënë dy projektet e zhvilluara me ekspertë ndërkombëtarë të njohur, me synimin kryesor trajnimin dhe përgatitjen e APAAL për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe hapat e tjerë që duhen ndjekur për këtë anëtarësim. Në fokus të aktiviteteve të organizuar nga APAAL ka qënë sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, metodat e vlerësimit, trajnimi i ekspertëve kombëtarë të vlerësimit me ekspertë të huaj etj. Një rëndësi të veçantë ka patur bashkëpunimi me kompaninë gjermane CHE (Center for Higher Education) gjatë zhvillimit të procesit të rankimit për vitin 2011. Tashmë struktura e re e ngritur në APAAL për realizimin e proceseve të renditjes dhe analizave në arsimin e lartë, ka kapacitetet e duhura për realizimin me sukses të këtyre proceseve në të ardhmen. Ndërkohë bashkëpunimi me CHE do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012.

#### **I.5. Mendime mbi strategjinë afatgjatë të zhvillimit të APAAL**

Analizat e kryer nga APAAL për situatën aktuale si dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë për konsolidimin e mëtejshëm të agjencisë, kanë nxjerrë në pah nevojën e disa ndryshimeve.

Drejtimit kryesorë strategjike për të ardhmen të APAAL janë:

- Krijimi i kuadrit të plotë ligjor që i siguron APAAL statusin e një autoriteti administrativ të pavarur, transparent dhe të paanshëm në përputhje me principet

bazë të Kriteve dhe Standarteve Europiane të Cilësisë, promovuar nga ENQA (Organizata Europiane për sigurimin e cilësisë).

- Garantimi i cilësisë së vlerësimeve duke përcaktuar një metodologji të përshtatshme për çdo strukturë të vlerësuar, duke siguruar cilësinë e grupeve të ekspertëve dhe duke integruar në aktivitetin e APAAL, sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.

- Pjesmarrja në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë përmes vendosjes së ekuilibrave ndërmjet autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe nevojave të tregut, ndjekjes hap pas hapi dhe ndihmës së IAL-ve të vlerësuara, nxitjes së debatit me gjithë aktorët dhe faktorët si edhe rritjes së aftësive profesionale vlerësuese të stafit të agjencisë.

- Arritja e dimensionit ndërkombëtar në të gjithë veprimtarinë e agjencisë përmes zhvillimit të mendimit, aftësive dhe rritjes së performancës ndërkombëtare në agjenci.

- Informatizimi i të gjitha procedurave të kryera nga APAAL, me qëllim jo vetëm për të rritur rendimentin e punës, por mbi të gjitha synim kryesor është përmirësimi i cilësisë së vlerësimeve dhe transparenca e tyre.

## II.RAPORT MBI VEPRIMTARITË KRYESORE TË APAAL GJATË VITIT 2011

### II.1. Vlerësime në kuadrin e licensimit dhe akreditimit të IAL dhe programeve

Gjatë vitit 2011 procesi i vlerësimit dhe akreditimit të IAL-ve, publike dhe private ka qënë pjesë e rëndësishme e punës së Sektorit të Vlerësimit dhe Promocionit por dhe e APAAL-it në përgjithësi.

Në vendin tonë operojnë 47 institucione të arsimit të lartë publike e private me një numër total prej 950 programesh të ofruara prej tyre. Më hollësisht:

**13** - IAL Publike

**5** - IAL in Tirana,

**6** - IAL rajonale

**1** - Akademi Ushtarake, **1** Akademi albanologjike

**5** - Fakultete në rrethe (filiale)

Në total **570** - programe studimi

**45** - IAL Private



**35** - IAL në Tiranë, 7- IAL qytete te tjera

**3** - Universitete, 26- Shkolla të Larta,

**4** - Filiale, 4 - Kolegje, 7- Akademi

Në total **380** - programe studimi

Gjatë vitit 2011 për institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat, janë shqyrtuar dhe vlerësuar 440 programe të reja studimi të të tre cikleve (174 publike dhe 266 private). Vërehet se aplikimet e bëra nga IAL private vazhdojnë të jenë në






numër më të madh në krahasim me ato të kërkuara nga IAL publike. Vetëm gjatë vitit 2011 janë përfunduar vlerësimet institucionale dhe të programeve për 7 IAL të reja të cilat janë licensuar, apo janë në proces licensimi.

Në lidhje me akreditimin, IAL-të kanë detyrim ligjor akreditimin e programeve para lëshimit të diplomave. Gjatë vitit 2011 ka patur kërkesa vetëm nga IAL-të private për akreditimin e programeve të ndryshme të dy cilkeve të studimit dhe për akreditim institucional apo njësive të tyre. Numri total i programeve/njësive të akredituara ka qënë 68. Në kuadër të përmirësimit të procesit të akreditimit, edhe pse akreditimi nuk kryhet ende me ekspertë të huaj, raporti i vlerësimit të brendshëm i IAL-ve dorëzohet në APAAL në gjuhën angleze.

## II.2. Renditja dhe analiza cilësore e krahasuese të institucioneve, fushave dhe programeve në AL

Renditja e institucioneve të arsimit të lartë ka qënë një ndër angazhimet kryesore i APAAL për vitin 2011. Me inicativë të MASH, CHE dhe APAAL realizuan me sukses për herë të parë në vend këtë projekt pilot. Renditja nënkupton krahasim institucionesh dhe programesh nëpërmjet disa indikatorëve sasiorë e cilësorë, nga të cilët nxirret një pamje reale e institucioneve të arsimit të lartë në vend. Renditja është shumë dimensionale dhe konceptohet në ndarjen në grupe dhe jo në një renditje



vertikale të IAL. Renditja bazohet në vetëdeklarimin e të dhënave të matshme e cilësore, me anën e pyetësorëve. Qëllimi kryesor i këtij procesi është të japë informacion studentëve të ardhshëm për të bërë zgjedhjen e duhur për vazhdimin e studimeve duke qënë të informuar për institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Në të njëjtën kohë renditja jep një pamje reale të sistemin arsimor në vend. Ndhmon gjithashtu institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet politikëbërëse. Gjatë këtij procesi, stafi



i sektroit të statistikave dhe analizave mori eksperiencën dhe trajnimin e nevojshëm nga kompania CHE. Në këtë proces morën pjesë 35 IAL në 4 fusha studimi (21 programe studimi në total): Drejtësi/Juridik; Infermieri/Fizioterapi/Mami; Shkenca Sociale; Ekonomi/Biznes; U shpërndanë 5 pyetësorë (për universitetin, fakultetin, programet, stafin akademik, studentët, ekspertet e APAAL) me një total prej 200 pyetjesh. U kryen rreth 50 seminare trajnuese në universitete dhe fakultete të ndryshme, u plotësuan pyetësorët prej rreth 12500 studentës dhe stafe akademike etj. Të dhënat u përpunuan në Gjermani nga CHE dhe APAAL ndërsa rezultatet janë bërë publike në media dhe në faqen e internetit të APAAL, ([www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al), [www.albranking.com](http://www.albranking.com)), dhe MASH.

Përfundimet e dala nga ky proces, janë analizuar dhe do të jenë pjesë e rekomandimeve që APAAL do të bëjë për institucionet e arsimit të lartë.

### **II.3. Aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e AL**

Stafi i APAAL ka qënë i angazhuar në mjaft aktivitete ndërkombëtare të zhvilluara gjatë 2011. Titullari i institucionit por edhe stafi i APAAL kanë qënë pjesë e disa grupe pune midis APAAL, MASH dhe insitucioneve të tjera. Përmendim këtu përfaqësimin e APAAL nga Drejtori në grupin e hartimit të standarteve dhe kritereve në arsimin e lartë dhe në grupe të tjera pune në MASH. Përgjegjësit e sektorëve janë pjesë e grupeve të punës të ngritura nga MASH për të kryer vizita në IAL. Stafi i APAAL ka dhënë kontribut në hartimin e udhëzimit për tarifat e reja për vlerësimin dhe akreditimin për institucionet dhe ekspertët vendas dhe të huaj dhe aktivitete të projektit “Cilësi e Barazi në Arsim”.

Ndër aktivitetet e tjera veçojmë:

- Aktivitete për trajnimin e përfaqësuesve të IAL publike dhe private për të ngritur dhe vënë në funksionim të plotë Njësitë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Në këtë aktivitet janë përfshirë shumë takime informuese si: takime me drejtuesit e APAAL, takim me drejtues të dy universiteteve publike, takim me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës si dhe me drejtues të lartë në MASH etj. Në këtë aktivitet u synua hartimi i një “Pakete Udhëzuese” për mirëfunksionimin e NJBSC me materialet trainuese, udhëzues për ngritjen e NJBSC, pyetësorë dhe rekomandimet përkatëse. Aktivitetet trainuese u zhvilluan në datat 22, 23 dhe 24 Nëntor në Tiranë, me pjesëmarrjen e rreth 120 personave, përfaqësues nga 13 IAL Publike dhe 26 IAL Private, përfaqësues të MASH dhe të ftuar të tjerë.
- Aktiviteti “*Ekspertizë ndërkombëtare për vlerësimin e jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë*” u zhvillua në 4 seminare trajnuese për ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe bashkëpunorët e APAAL sipas 4 fushave (Ekonomike, Shkenca Inxhinierike, Shkenca të Kujdesit Shëndetësor, Shkenca Humane dhe fusha të përafërta.
- Pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga Universiteti Fatih, “*Shkëmbimi i eksperiencës në standardet ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit*”, në datat 22-25 shkurt 2011, Stamboll, Turqi

- Pjesmarrje në Asamblenë e Përgjithshme dhe Workshop-in e CEE Network (Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education) organizuar në Split, Kroaci në datën 27-28 Maj.
  - Pjesmarrje në workshopin me temë “Implementing of the ESG (European Standards Guidelines) in the Balkan Region”, organizuar nga ENQA/UNESCO-GIQAC, me datën 16-17 Qershor 2011, Vjenë, Austri
  - Pjesmarrje në “Asamblenë e Përgjithshme” të ENQA (European Association for quality Assurance in Higher Education), organizuar në Bukuresht, Rumani me datën 06-07 tetor 2011,
  - Pjesmarrje në “Konferencën Ndërkombëtare të Arsimit të Lartë (HEIC)”, organizuar nga Ministria e Arsimit të Libanit”, Bejrut, Liban me datën 31 tetor – 02 nëntor 2011,
  - Pjesmarrje në Konferencën Ndërkombëtare, “Sigurimi i Cilësisë”, organizuar nga Komisioni Europian në Bruksel, Belgjikë, me datën 14 dhjetor-15 dhjetor 2011,
- Akivitete në kuadër të CBA*
- Staf i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë mori pjesë në Gjermani, Gütersloh në një vizitë trajnimit në kompaninë fituese për procesin e renditjes së universiteteve në Shqipëri, CHE (Center for Higher Education).
  - Pjesmarrje në Simpoziumin e 3-të vjetor “Për renditjen e universiteteve dhe sigurimin e cilësisë në Europë, 2011” të organizuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim me Komisionin Europian dhe CHE, në Bruksel, Belgjikë.

### **III.PLANI I VEPRIMTARISË PËR VITIN 2012**

#### **III.1. Plani i veprimtarive në kuadrin e përmirësimit të organizimit dhe funksionimit të APAAL**

Planin e aktiviteteve për vitin 2012, APAAL e ka përgatitur në fund të viti 2011 dhe i është dërguar MASH. Një pjesë të rëndësishme në këto aktivitete zënë veprimtaritë në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor në të cilin mbështetet funksionimi i APAAL, bazuar dhe në rekomandime të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë me të cilët APAAL bashkëpunoi gjatë vitit 2011. Këto përmirësime përfshijnë hartimin e një sërë dokumentesh dhe procedurash për proceset e vlerësimit, akreditimit, rankimit dhe analizave në arsimin e lartë. Një pjesë e tyre do të rishikohen dhe përshtaten në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë si p.sh: Procedurat për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit; Procedurat për vlerësimin dhe akreditimin e një institucioni të ri në arsimin e lartë. Do të hartohen procedurat e procesit të rankimit dhe analizave në arsimin e lartë, do të rishikohen dhe përmirësohen pyetësorët për këto procese etj.

APAAL është në fazën e implementimit të një sistemi informatik për menaxhimin e të gjithë aktivitetit të agjencisë. Nëpërmjet tij agjencia synon të rrisë performancën dhe transparencën në aktivitetet e saj dhe të KA. Kryerja e vlerësimeve on-line nga ekspertë ndërkombëtarë, marrja e mendimeve nga të gjithë faktorët e arsimit të lartë, krijimi i bazës kombëtare të të dhënave për arsimin e lartë si dhe informacioni i besueshëm dhe në kohë reale do të jenë disa nga përfitimet e implementimit të këtij


projekti. Gjithashtu janë duke u përgatitur rregulloret e sistemit të menaxhimit elektronik të të dhënave, rregullorja e administrimit të sistemit etj.

### III.2. Plani i aktiviteteve në kuadrin e vlerësimit, akreditimit, renditjes së IAL dhe analizave në AL

Proceset kryesore në të cilat bazohet aktiviteti i APAAL, do të vazhdojnë të kenë rolin kryesor në aktivitetin e saj për vitin 2012.

a. Vlerësimi në kuadrin e hapjes së programeve të reja në institucionet publike dhe private, të reja apo ekzistuese, do të vazhdojë edhe gjatë 2012. Edhe pse aplikimet për hapjen e programeve të reja janë zvogëluar, APAAL parashikon se edhe në vitin 2012 do të këtë aplikimi për hapje programesh të reja kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve.

b. Procesi i akreditimit do të zërë një peshë të madhe në aktivitetin e APAAL, një pjesë e IAL-ve kanë aplikuar në vitin 2011 dhe akreditimi i tyre do të zhvillohet gjatë 2012. Ndërkohë që vazhdojnë edhe gjatë këtij viti aplikimet për akreditim të programeve dhe institucioneve. Të gjitha këto vlerësime kryhen në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë, të miratuara në vitin 2011. Aplikimi i institucioneve publike të arsimit të lartë për t’ju nënshtruar procesit të akreditimit vazhdon të jetë i ulët, ç’ka përbën një shqetësim serioz për APAAL. Për të rritur sensibilizimin e këtyre institucioneve, agjencia parashikon të ndërmarrë disa iniciativa që lidhen kryesisht me informimin e studentëve dhe stafeve akademike për detyrimin ligjor që kanë këto institucione për kryerjen e këtij procesi si dhe përfitimet që dalin prej tij. Organizimi i disa takimeve me fakultetet dhe universitetet publike e private, diskutimi i rrugëve të monitorimit të cilësisë në institucioneve, diskutimi për orientimin e drejtë të programeve mësimore në përputhje me tregun e punës, do të jenë pjesë e tematikës në këto takime.



Aktivitetet në kuadrin e akreditimit për vitin 2012			
IAL që kanë aplikuar	IAL	Nr.	Periudha e planifikuar
PAVARESIA	1	5	Tremujori IV (2011 -12)
LOGOS	1	5	Tremujori I (2012)
ILLYRIA	1	1	6 Mujori i II (2011 -12)
VITRINA	1	8	Tremujori I (2012)
SHKOLLA E LARTE E EDUKIMIT	1	2	Korrik (2011 -12)
KRISTALI		9	Tremujori I dhe III (2012)
ALDENT		2	Tremujori II (2012)

PLANETARI	1	7	Tremujori II(2012)
BEDER	1	4	Tremujori IV (2013)
UNYT		3	Tremujori II (2011 - 12)
UNYT		1	Tremujori I (2012)
ALBANIA UNIVERSITY		14	Tremujori I (2012)

c. Pas përfundimit me sukses të procesit të renditjes së IAL, APAAL është institucioni përgjegjës që do të kryejë këtë proces të përvitshëm. Aktualisht janë diskutuar fushat dhe programet që do të jenë pjesë e këtij procesi gjatë vitit 2012.

APAAL ka propozuar që renditja e IAL-ve për vitin 2012 të kryhet për tre fusha studimi (Drejtësi, Ekonomi-Biznes dhe Mësuesi). Dy fushat e para janë përzgjedhur për të konsoliduar procesin e rankimit ndërsa mësuesia është përzgjedhur si mbështetje ndaj politikave arsimore të MASH për rritjen e cilësisë së studentëve të diplomuar në mësuesi. Plotësimi i formularëve të aplikimit do të fillojë në muajin shkurt, testimi i pyetësorëve dhe mbledhja e të dhënave do të fillojë në muajin mars.

d. Gjatë vitit 2012, APAAL parashikon të kryejë disa analiza në arsimin e lartë kryesisht për ato fusha dhe programe që kanë një interes të madh publik dhe që nuk ofrohen nga një numër i madh institucioneve dhe për këtë arsye nuk mund të përfshihen në procesin e rankimit. Programet janë diskutuar në APAAL dhe është vendosur të futen në këtë proces disa indikatorë të vecantë të fushave mjekësore (mjekësi, farmaci stomatologji) dhe inxhinierike (inxhinieri ndërtimi, ushqimore e mjedisi). Mbledhja e të dhënave dhe etapat e këtij procesi do të jenë të njëjta me procesin e rankimit, por analiza që do të kryhet do të jetë në funksion të cilësisë së disa treguesve si pajisjet laboratorike, praktikat profesionale, stafi akademik etj.

Për të zhvilluar këto procese APAAL është në kontakt të vazhdueshëm me CHE (e cila do të jetë bashkëpunatore e APAAL edhe gjatë vitit 2012) dhe me agjenci të tjera që kryejnë procese të ngjashme në vende të ndryshme. Një nga këto projekte që ka rëndësi edhe për arsimin shqiptar është dhe “University Multirank”, i inicuar nga Komisioni Europian. APAAL synon që edhe vendi ynë të bëhet pjesë e këtyre zhvillimeve globale duke futur disa nga IAL tona në renditjet europiane e botërore të insitucioneve të arsimit të lartë.

Aktivitete e planifikuara për renditjen dhe analiza e IAL							
Rankimi: Drjetesi, Ekonomi-biznes, Mesuesi							
Analiza: (Mjekësi, farmaci stomatologji) dhe (inxhinieri ndërtimi, ushqimore e mjedisi)							
Aktiviteti	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik
Njoftimi i IAL							
Plotësimi i formularit							
Finalizimi i pyetësoreve							
Testimi i pyetësoreve							

Pyetesori i Univ								
Pyetesori i Fakulteteve								
Pyetesori i Programeve								
Pyetesori i studenteve								
Pyetesori i stafeve								
Pyetesori i të diplomuaëve								
Verifikimi i te dhenave								
Korigjimi përfundimtar								
Analiza paraprake								
Analiza përfundimate								
Përgatitja e raportit final								
Publikimi i rezultateve								

### III.3. Plani i aktiviteteve në kuadrin e anëtarësimit në ENQA dhe bashkëpunimet ndërkombëtare

Anëtarësimi në ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education) dhe në Regjistrin European të Agjencive (EQAR), janë dy synimet kryesore që APAAL kërkon të arrijë në të ardhmen. Pjesë e këtyre përpjekjeve kanë qënë dy aktivitete të zhvilluara gjatë vitit 2011, “Ekspertizë ndërkombëtare për zhvillimin e veprimtarive të APAAL” dhe “Mbështetje APAAL-it për të arritur standardet ndërkombëtare”. Këto aktivitete kanë si qëllim përgatitjen e stafit të APAAL për hartimin e raportit të vetëvlerësimit për anëtarësimin në ENQA dhe EQAR. Për të realizuar këtë aktivitet APAAL ka përzgjedhur eksperet më të mirë ndërkombëtarë. Ekspertët kanë zhvilluar disa takime në APAAL dhe MASH, në fokus të të cilave ka qënë marrja e informacioneve të duhura për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të gjithë strukturave të APAAL dhe organeve të tjera që operojnë në fushën e arsimit të lartë. Një pjesë e rekomandimeve dhe sugjerimeve nga ekspertët, kanë mbërritur në APAAL dhe po shqyrtohen me kujdes. Në agjenci është ngritur një grup punë i përbërë nga ekspertët me të mirë shqiptarë të fushave të ndryshme dhe njohës të mirë të arsimit të lartë të cilët do të bashkëpunojnë më APAAL për përmirësimin e dokumentacionit dhe procedurave të funksionimit të agjencisë, në përputhje me standartet e ENQA dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë. APAAL do të hartojë raportin e vlerësimit të brendshëm dhe parashikon që brenda vitit 2012 të aplikojë në ENQA për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm nga kjo agjenci. Synim është gjithashtu dhe përshtatja e dokumentacionit të APAAL në përputhje me standartet europiane të sigurimit të cilësisë. Rekomandimet e bëra nga ekspertët

ndërkombëtarë për bazën ligjore të funksionimit të APAAL do t'i dërgohen MASH. Rëndësi do ti kushtohet bashkëpunimit me agjencitë homologe e partnere të APAAL (pjesë të rrjetit ENQA, CENetwork, INQAHE) jo vetëm në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimin eksperiencës por edhe në shkëmbimin e ekspertëve të vlerësimit për fusha të ndryshme studimi. Të gjitha programet e studimit në APAAL dhe akreditimi aplikohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), duke krijuar në këtë mënyrë vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë. APAAL do të jetë iniciatore e një seminari rajonal, me pjesëmarrjen e rreth 15 agjencive të rajonit për unifikimin e Standardeve Europiane për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në vendet e rajonit, si dhe rritja e bashkëpunimit për procese të përbashkëta akreditimi dhe rankimi apo krijimin e një grupi ekspertësh të përbashkët të rajonit.

#### **IV.VETVLERËSIMI I PERFORMANCËS SË APAAL**

##### **IV.1. Analiza vjetore e performancës së APAAL për vitin 2011, arritjet, problematikat dhe përfundimet**

Agjencia e akreditimit, bazuar në planin e veprimtarive për vitin 2011, ka realizuar me sukses pjesën më të madhe të objektivave. Proceset kryesore të aktivitetit të APAAL, si vlerësimi, akreditimi dhe rankimi, kanë zënë volumnin më të madh të punës.

Janë vlerësuar dhe rivlerësuar programet e studimit që kanë mbërritur në agjenci të shoqëruar me raportet individuale të vlerësimit teknik dhe të ekspertëve. Janë kryer në kohë proceset e parashikuara të akreditimit, përfshirë këtu trajnimet e njësisive të IAL-ve, vizitat në institucione, raportet e dorëzuara nga ekspertët dhe vënia në dispozicion të të gjithë dokumentacionit Këshillit të Akreditimit. Janë shtyrë për vitin 2012 dy procese akreditimi, si rezultat i mosdorëzimit të raportit të vlerësimit të brendshëm nga IAL-të, ose vonesa të ekspertëve në hartimin e raporteve të vlerësimit të jashtëm. Gjithsesi realizimi i këtyre dy proceseve konsiderohet i suksesshëm nga APAAL.

Mbyllja me sukses e procesit të rankimit dhe publikimi i rezultateve në 15 korrik 2011, para regjistrimit të studentëve kandidatë në shkollat e larta, është përsëri një arritje pozitive e APAAL. Studentët e ardhshëm tashmë kanë një informacion mbi institucionet e arsimit të lartë në vend, cilësinë e tyre në indikatorë të ndryshëm, ç'ka u mundëson atyre të bëjnë zgjedhjen e duhur të institucionit ku ata do të studiojnë.

Stafi APAAL krijoi 4 formate raportesh (BSc, Mp, MSc, Dr) të vlerësimit të programeve në përputhje me standartet e reja shtetërore të cilësisë. Këshillit të Akreditimit dhe ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, APAAL u ka vënë në dispozicion të gjithë asistencën dhe facilitetet e duhura për realizimin me sukses të aktiviteteve të tyre.

Agjencia në vijimësi të komunikimit me IAL-të, ka patur kontakte të vazhdueshme me institucionet. Nga APAAL u është vënë në dispozicion materiale dhe botime të



agjencisë si dhe u janë bërë sqarimet e duhura për procese të ndryshme që u kryen gjatë 2011.

Për sigurimin e cilësisë në IAL dhe konsolidimin e njësisë të brendshme të sigurimit të cilësisë dhe trajnimin e ekspertëve të jashtëm, APAAL organizoi 8 seminare trajnimi me ekspertë ndërkombëtarë të fushave të ndryshme.

Si detyrim ligjor, informimin e publikut, APAAL ka riorganizuar faqen e saj të internetit ([www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)) në version dinamik si dhe ka publikuar faqen e re të dedikuar për rezultatet dhe proceset e rankimit ([www.albranking.com](http://www.albranking.com)), që agjencia do të kryejë në të ardhmen. Një informacion i hollësishëm u është dhënë gjithashtu të interesuarëve që kanë ardhur në zyrat e APAAL

Agjencia ka një realizueshmëri prej 80% të projekteve Cilësi e Barazi në Arsim (CBA), duke treguar në këtë mënyrë përkushtimin e stafit të APAAL. Dy projekte janë në vijueshmëri në vitin 2012. Ndërkohë në kuader po të aktiviteteve të CBA, agjencia ka përgatitur dokumentacionin për projektin e informatizimit të APAAL, i cili pritet të përfundojë brenda 4 mujorit të parë të 2012 dhe do të ndryshojë pozitivisht mënyrën e funksionimit, rritjes së efektivitetit në punë, transparencën dhe besueshmërinë e APAAL.

Mungesa e një sistemi informatik dhe menaxhimi dhe mungesa e një baze të mirëfilltë të dhënash (një sistem i tillë është duke u implementuar në APAAL) ka ndikuar në disa raste në kryerjen jo në kohë të procedurave të parashikuara. Kjo ka sjellë gjithashtu vonesë në realizimin e disa analizave emergjente në arsimin e lartë (si p.sh analiza e stafeve akademike të IAL-ve) por edhe shtyrjen e procesit të renditjes së IAL-ve për vitin 2012.

APAAL nuk arriti të kryejë vetëvlerësimin e brendshëm për anëtarësimin në ENQA, proces i cili është shtyrë për vitin 2012. Kjo jo vetëm për shkak të një mungese të theksuar të eksperiencës të stafit të APAAL, ngarkesës së madhe të punës por edhe të disa mangësive dhe problematikave të vërejtura nga ekspertët ndërkombëtarë, të cilat duhen të korrigjohen dhe përshtaten me standartet europiane të ENQA. Një analizë e gjërë po u bëhet këtyre rekomandimeve dhe pjesa më e madhe e tyre me karakter procedural dhe organizativ, të agjencisë, janë drejt finalizimit.

Në përmbledhje të këtij raporti, theksojmë se Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, si institucion që operon në fushën e arsimit të lartë, ka kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Implementimi i sistemit të Bolonjës dhe riorganizimi i të gjitha programeve të studimit brenda një periudhe kaq të shkurtër është kontribut edhe e APAAL/KA. Në aktivitetin e saj, agjencia është përpjekur të ruajë kriteret dhe standartet shtetëore e europiane në arsimin e lartë por jo në çdo rast e ka arritur këtë qëllim. Zhvillimi kaq i vrullshëm i arsimit të lartë në vend, me një mesatare vjetore të 4 viteve të fundit prej rreth 500 programe studimi të vlerësuara për vit, është një tregues i qartë se APAAL ka patur një ngarkesë të madhe pune e cila ka sjelle një rritje të performancës së agjencisë. APAAL ka tashmë eksperiencën, mekanizmat dhe bashkëpunimet e duhura për të kryer me sukses misionin e saj themelor, rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Kryerja e disa ndryshimeve të



domosdoshme strukturore, krijimi i hapësirave të duhura ligjore për pavarësi transparencë dhe paanshmëri, do të bëjë të mundur realizimin e misionit të APAAL për garantimin e rritjes cilsore të arsimit të lartë që tashmë është edhe një objektivi madhor i qeverisë shqiptare.

Anëtarësimi në ENQA dhe EQAR do të jetë edhe një garanci për realizimin e këtij misioni që ka APAAL

*Tiranë, janar 2012*